



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna Drenas

Zyra e Kryetarit

Nr. 039-1612 më 12.01.2016

Nga: Kryetari i Komunës së Drenasit z. **Nexhat Demaku**

Për: Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal



LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më datën: 29.12.2015

1. Plani strategjik lokal për trajtimin dhe parandalimin e korrupsionit
2. Vendim për vazhdimin e kontratave mbi dhënie në shfrytëzim të banesave sociale në BLL.I dhe II në Drenasim III në Qendren e banimit social
3. Rregullore për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Drenasit

Drenas

12.01.2016



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glogocit)



Kuvendi i Komunës
Nr. 023-218 dt 08.01. 2016

PLANI STRATEGJIK

LOKAL PËR TRAJTIMIN DHE PARANDALIMIN E KORRUPCIONIT

Drenas, dhjetor 2015

Përmbajtja

1. VIZIONI

2. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

3. AKTIVITETE TË NDJESHME NDAJ KORRUPSIONIT TË ADRESUARA NË KËTË PLAN STRATEGJIK

3.1.Administratë lokale funksionale, transparente dhe të pranueshme për qytetarët

3.2.Lejet e ndërtimit

3.3.Kontrolli i ndërtimit (nëse ndërtuesi respekton kushtet e përfshira në lejen e ndërtimit dhe legjislacion të lidhura me sigurinë e ndërtesave)

3.4.Menaxhimi me shërbime komunale (ujëra të zeza, ujë dhe mbeturina)

3.5.Lejet mjedisore, mbrojtja e mjedisit

3.6.Menaxhimi i pronës publike dhe parandalimi i uzurpimeve

4. PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË

4.1.Administratë lokale funksionale, transparente dhe të pranueshme për qytetarët

4.2.Lejet e ndërtimit

4.3.Kontrolli i ndërtimit (nëse ndërtuesi respekton kushtet e përfshira në lejen e ndërtimit dhe legjislacion të lidhura me sigurinë e ndërtesave)

4.4.Menaxhimi me shërbime komunale (ujëra të zeza, ujë dhe mbeturina)

4.5.Lejet mjedisore, mbrojtja e mjedisit

4.6.Menaxhimi i pronës publike dhe parandalimi i uzurpimeve

1. VIZIONI

Ekzekutivi i komunës së Drenasit është një qeveri lokale e besueshme, që njih dhe plotëson nevojat e qytetarëve për ndërtimin e një komune me të ardhme, bazuar në principet e drejtësisë, barazisë, transparencës dhe integritetit moral.

1. OBJEKTIVAT STRATEGJIK

- 1.1. Forcimi /fuqizimi i auditit të brendshëm të komunës.
- 1.2. Rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës brenda strukturës së komunës dhe ndaj qytetarëve.
- 1.3. Zbatimi korrekt i legjislacionit dhe të gjitha rregulloretë të brendshme të komunës (ritje të njohurive mbi legjislacionin, vendosja e sanksioneve bazuar në ligj dhe zbatimi i ligjit).

2. AKTIVITETE TË NDJESHME NDAJ KORRUPSIONIT TË ADRESUARA NË KËTË PLAN STRATEGJIK

- 2.1. Administratë lokale funksionale, transparente dhe të pranueshme për qytetarët
- 2.2. Lejet e ndërtimit
- 2.3. Kontrolli i ndërtimit (nëse ndërtuesi respekton kushtet e përtshira në lejen e ndërtimit dhe legjislacion të lidhura me sigurinë e ndërtesave)
- 2.4. Menaxhimi me shërbime komunale (ujëra të zeza, ujë dhe mbeturina)
- 2.5. Lejet mjedisore, mbrojtja e mjedisit
- 2.6. Menaxhimi i pronës publike dhe parandalimi i uzurpimeve

PLANI STRATEGJIK

1. Administratë lokale funksionale, transparente dhe të pranueshme për qytetarët

Objekti i përgjithshëm: Përmirësimi i shërbimeve administrative, transparencja në ofrimin e shërbimeve ngritja e efikasitetit në punë, dhe krijimi i shërbimeve me sistem të hapur, sidomos për ato shërbime për të cilat çdo ditë qytetarët kanë nevojë për to.

Objektivat specifike:

OS1. Ngritja e kapaciteteve profesionale në punë duke vënë në njësi të përkatëse administrative njëriçz profesionalë dhe njohës të çështjeve administrative.

OS2. Vazhdimi i hapjes së zyrtare për ofrimin e shërbimeve me sistem të hapur për shërbimet për të cilat qytetarët kanë nevojë çdo ditë për to.

OS3. Përshtatja e një sistemi të ankesave që qytetarët do të mund të adresojnë shqetësimet e tyre dhe që shqyrtimi i ankesave të jetë i përnjohshëm nga ana menaxhmenti në pajtim me procedurat ligjore.

2. Lejet e ndërtimit

Objekti i Përgjithshëm: Hartimi i planeve të brendshme të Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, për të zbatuar pengesat që mund të gjenerojnë nga kompleksiteti i çështjeve dhe ndikimet e ndryshme tëj.

Objektivat Specifikë:

OS1: Shqyrtimi me kohë i aplikimeve për leje ndërtimore, zhvillimi dhe zbatimi korrekt i mbledhjes taksave dhe gjobave,

OS2: Krijimi i një sistemi vlerësimi dhe motivimi të drejtë dhe periodik për stafin bazuar në profesionin dhe eksperiencën e tyre në punë

OS3: Ngritja profesionale dhe forcimi i kontrollit të brendshëm të inspeksionit mbi lejet e ndërtimit dhe çështjet tjera urbane.

3. Kontrolli i lejeve të ndërtimit (nëse ndërtuesi respekton kushtet e përfshira në lejen e ndërtimit dhe legjislacion të lidhura me sigurinë e ndërtesave)

Objekti i Përgjithshëm: Rritja e përgjegjshmërisë së zyrtareve publikë dhe kompanive të ndërtimit në lidhje me respektimin e kushteve të përfshira në lejet e ndërtimit dhe legjislacion, të lidhura me sigurinë e ndërtesës dhe zbatimin e kushteve urbane të përcaktuara në plane rregulluese

Objektivat Specifike:

OS1: Parandalimi i ndërtimit të ndërtesave të reja pa leje

OS2: Korigjimi i situatës lidhur me ndërtimet ekzistuese pa leje (legalizimi) dhe mos legalizimi i ndërtimeve pa leje të cilat kanë ndodh pas prerjes së gjendjes me hyrjen në fuqi të ligjit për legalizimin e ndërtimeve pa leje.

4. Menaxhimi me shërbime komunale (ujëra të zeza, ujë dhe mbeturina)

Objekti i Përgjithshëm: Përmirësimi i sistemit të menaxhimit me shërbimet komunale dhe bashkëpunim me Ndërmarrje të Ujësjellësit dhe atë të Mbeturinave në Drenas.

Objektivat Specifike:

OS1: Rritja e kontrollit të inspektimeve lidhur me keqpërdorimet me ujë dhe trajtimi i mbeturinave

OS2: Nxjerrja e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave dhe harmonizimi i rregulloreve aktuale që rregullojnë çështjet në fjalë.

OS3: Informim i drejtë i qytetarëve lidhur me pasojat eventuale lidhur me mbrojtjen e shëndetit publik si pasojë e keqmenaxhimit dhe keqpërdorimit.

5. Lejet mjedisore, mbrojtja e mjedisit

Objekti i përgjithshëm: Sigurimi i një procesi të drejtë dhe korrekti për lëshimin e lejeve mjedisore dhe mbrojtjen e mjedisit

Objektivat specifike:

OS1: Rritja e ndërgjegjësimi dhe përgjegjshmërisë së komunës mbi mbrojtjen e mjedisit

OS2: Rritja e transparencës mbi institucioneve të përfshira në dhënie lejeve mjedisore (komunale dhe qendrore) dhe ndaj publikut

6. Menaxhimi i pronës publike dhe parandalimi i uzurpimeve

Objekti i përgjithshëm: Evidentimi i plotë i pronës komunale dhe shfrytëzimi adekuat i tyre.

Objektivat specifike:

OS1: Rritja e përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë së organeve komunale në menaxhimin me pronë komunale

OS2: Përshtetimi i procedurave të monitorimit dhe evidentimit të uzurpimeve dhe kthimi i uzurpimeve

OS3: Ngritja profesionale dhe kontrolli në zbatimin e ligjeve të pronës.

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË

1. Administratë lokale funksionale, transparente dhe të pranueshme për qytetarët

Veprimet	Kush është përgjegjës	Me kë	Afati i realizimit	Indikatorët e suksesit
OS1. Ngritja e kapaciteteve profesionale në punë duke vënë në njësitë përkatëse administrative njëzëz profesionale dhe njohës të çështjeve administrative.	Përcjellja e performances profesionale për të punësuarit dhe gradimet adekuate	Kryetari i Komunës	Drejtorët e drejtorive dhe njësia e personelit	Transparenca dhe performanca
	Evidentimi i zyrtarëve profesionistë - gjenerues	Kryetari i Komunës	Drejtorët e drejtorive dhe njësia e personelit	Shpallja e zyrtarëve të suksesshëm -performues
OS2. Vazhdimi i hapjes së zyrrave për ofrimin e shërbimeve me sistem të hapur për shërbimet për të cilat qytetarët kanë nevojë çdo ditë për to.				
Hartimi i një plani konkret për ofrimin e shërbimeve në sistem të hapur	Drejtorët e drejtorive	Udhëheqësit e sektorëve dhe njësite tjera përkatëse	24/muaj	Miratimi i planit
Emërtimi i sporteleve me emërtimet përkatëse	Drejtorët e drejtorive	Udhëheqësit e sektorëve dhe njësite tjera përkatëse	12/muaj	Funksionalizimi i zyrrave
OS3. Përshtatja e një sistemi të ankesave që qytetarët do të mund të adresojnë shqetësimet e tyre dhe që shqyrtimi i ankesave të jetë i përnjëhershëm nga ana menaxhmentit në pajtim me procedurat ligjore.				
Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve	Drejtorët e drejtorive	Udhëheqësit e sektorëve dhe njësite tjera përkatëse	1 përhershëm	Bërja publike e ankesave
Emërimi i trupave-komisioneve në pajtim me ligjet në fuqi.	Drejtorët e drejtorive	Udhëheqësit e sektorëve dhe njësite tjera përkatëse	1 përhershëm	Njoftimi publik për ekzistimin e trupës-komisioni
Raportimet e përhershme lidhur me punët e komisioneve	Udhëheqësit e komisioneve		Çdo 3/muaj	Bërja publike e raporteve

2. Lejet e ndërtimit

OS1: Shqyrtimi me kohë i aplikimeve për leje ndërtimore, zhvillimi dhe zbatimi korrekt për dhënjën e lejeve të ndërtimit në harmoni me planet rregulluese dhe urbane

Ushtrimi i kontrollit periodik (3 mujor) nga auditi i brendshëm mbi dhënjën e lejeve ndërtimore dhe certifikatave të përdorimit	Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit	Udhëheqësit e sektorit në DUPMM dhe Drejtori	Raportet 3-mujore të kontrollit nga auditi i brendshëm
Ekzekutimi i sanksioneve në përputhje me ligjin për të gjithë punonjësit që thyejnë ligjin.	Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit	Njësia e personelit; Auditi i brendshëm	Detyrë e përbërshme Dokumentum i masave konkrete që do të merren në rastë shkeljeshe nga stafi i Planit Urbanistik

OS2: Krijimi i një sistemi vlerësimi dhe motivimi të drejtë dhe periodik për stafin bazuar në profesionin dhe eksperiencën e tyre në punë.

Trajnime për stafin e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit (sidomos me stafin e inspektoratit të ndërtimit dhe mbrojtje të ambientit)	Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit	Njësia e personelit	Detyrë e përbërshme Numri i trajnimeve të zhvilluara dhe zyrtarëve të trajnuar
--	---	---------------------	---

OS3: Ngritja profesionale dhe forcimi i kontrollit të brendshëm të inspeksionit mbi lejet e ndërtimit dhe gëshitjet tjera urbane. Inspektimi në sferën e ndërtimit në baza profesionale	Drejtoria e Inspeksionit Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit	Njësia e personelit	Detyrë e përbërshme Numri i inspektorëve të ngritur profesionalisht.
---	--	---------------------	---

3. Kontrolli i lejeve të ndërtimit (nëse ndërtuesi respekton kushtet e përfshira në lejen e ndërtimit dhe legjislacion të lidhura me sigurinë e ndërtësave)

OS1: Parandalimi i ndërtimit të ndërtësave të reja pa leje.				
Aplikimi i masave të forta ndëshkuese për kompanitë/individët që thyjnë kushtet në lejet e ndërtimit lidhur me sigurinë e ndërtësës	Drejtoria e Inspektionit Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit	Inspektorët dhe Policia	Detyrë e përhershme	Numri dhe lloji i masave ndëshkuese të aplikuar
Evidentimi i ndërtësave pa leje dhe gjobitja e tyre	Inspektorati i Ndërtimit	Drejtoria e Inspektionit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit; Policia	Detyrë e përhershme	Plani i veprimit i dizenjuar dhe aplikuar
Shembja e ndërtësave pa leje jashtë planit rregullues.	Inspektorati i Ndërtimit	Drejtoria e Urbanizimit, Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Policia	Detyrë e përhershme	Numri i ndërtimeve pa leje të shembura
OS2: Korrigjimi i situatës lidhur me ndërtimet ekzistuese pa leje (legalizimi) dhe moslegalizimi i ndërtimeve pa leje të cilat kanë ndodhur pas prerjes së gjendjes me hyrjen në fuqi të Ligjit për Legalizimin e Ndërtimeve pa Leje.				
Regjistrimi i ndërtimeve pa leje	Drejtoria e Urbanizimit, Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit; Inspektorati	Sektorët përkatës dhe imputet tjera që ka në ndihmë	Detyrë sipas afatit ligjor	Numri i gjithëmbarshtëm i ndërtimeve pa leje dhe atyre të reja pa leje.
Zbatimi i Ligjit për Legalizim të Ndërtimeve pa Leje; Evidentimi i ndërtimeve të cilat nuk ka mundësi të inkorporohen në plane rregulluese dhe nuk e kanë të zgjidhur çështjen pronësore.	Drejtoria e Urbanizimit, Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit	Sektorët përkatës dhe imputet tjera që ka në ndihmë	Detyrë sipas afatit ligjor	Numri i ndërtimeve të legalizuara dhe numri i ndërtimeve pa leje pas ortofotove të bëra të ndërtimeve në pajtim me ligjin për legalizim

4. Menaxhimi me shërbime komunale (ujëra të zeza, ujë dhe mbeturina).

OS1: Rritja e kontrollit të inspektimeve lidhur me keqpërdorimet me ujë dhe trajtimi i mbeturinave				
Kontrollimi i përditshëm i përdorimit të ujit, ujërave të zeza dhe mbeturinave	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Inspektoratit; DPUMM	Me Inspektorët	Afati i përhershëm	Rezultatet e inspektimeve (nr. i tyre brenda një muaji)
Evidentimi i lokacioneve/vendeve të egër të mbeturinave	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Inspektoratit; DPUMM	Me Inspektorët	Afati i përhershëm	Shpallja e vendeve të egër të mbeturinave
Hartimi i një plani për menaxhimin e ujërave të zeza, ujit dhe mbeturinave dhe përcaktimi i masave adekuate.	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Inspektoratit; DPUMM	Drejtoritë tjera	12/muaj	Miratim i Planit
OS2: Nxjerrja e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave dhe harmonizimi i rregulloreve aktuale që rregullojnë çështjet në fjalë.				
Zbatimi i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Inspektoratit dhe DPUMM	Zyrën Ligjore	E përhershme	Zbatimi dhe monitorimi i Rregullores
OS3: Informim i drejtë i qytetarëve lidhur me pasojat eventuale lidhur me mbrojtjen e shëndetit publik si pasojë e keqmenaxhimit dhe keqpërdorimit.				
Informimi i qytetarëve për marrjen e masave të domosdoshme për ngrijen e vetëdijes tek qytetarët	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.	Me QKMF-në dhe sektorët tjerë shëndetësorë dhe media lokale të informimit	Detyrë e përhershme	Takimet, tryezat, fushata mediale etj.

5. Lejet mjedisore, mbrojtja e mjedisit

OS1: Rritja e përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë së organeve komunale në menaxhimin me pronë komunale				
Ushtrimi periodik i kontrollit ndaj operatorëve të biznesit bazuar në një program të planifikuar mujor	Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes të Mjedisit (Sektori i Mjedisit), Drejtoria e Inspektoratit	Inspektori i mjedisit dhe policia	Detyrë e përkthshme	Raporte mujore mbi kontrollin që reflektojnë përmirësimin e perspektivës së mjedisit të qytetit
Planifikimi i më shumë investimeve në buxhet për vitet në vazhdim për problemet e mjedisit	Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes të Mjedisit (Sektori i Mjedisit)	Sektorin e Mjedisit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Kryetari/Nënkryetari	12/muaj	Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës
Hartimi i Planit Komunal për Mjedisin	Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes të Mjedisit (Sektori i Mjedisit)	Zyra ligjore		Monitorimi mbi zbatimin e planit
OS2: Rritja e transparencës midis institucioneve të përfshira në dhënien e lejeve mjedisore (Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes të Mjedisit) dhe ndaj publikut				
Organizimi i një fushate për trijën e ndërgjegjësimit nëpërmjet TV, radios, fletëpalosje, gazeta, nga Komuna për të informuar komunitetin mbi legjislacionin mjedisor	Drejtoria Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes të Mjedisit (Sektori i Mjedisit)	Kryetari	12/muaj	Numri i reklamave në TV, numri i fletëpalosjeve të shpërndara, njoftimet në gazeta
Konsultime të rregullta me grupet e interesit mbi mbrojtjen e mjedisit	Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes të Mjedisit (Sektori i Mjedisit)	Kryetari	12/muaj	Numri i takimeve të realizuara, numri i pjesëmarrësve në takime

6. Menaxhimi i pronës publike dhe parandalimi i uzurpimeve

OS1: Rritja e përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë së organeve komunale në menaxhimin me pronë komunale				
Kryerja e monitorimit periodik mbi respektimin e ligjeve të pronës, detyrimet dhe shërbimet	Drejtori i Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë.	Sektorin e pronës Kryetari i Komunës	Detyrë e përhershme	Regjistri i kontrolleve i plotësuar dhe kontrolluar Reduktimi në zero i uzurpimeve të pronës komunale.
OS2: Përshtetësi i procedurave të monitorimit dhe evidentimit të uzurpimeve dhe kthimi i uzurpimeve				
Evidentimi dhe hartimi i listës së uzurpimeve dhe mënyra e kontrollimit të keqpërdorimit të pronës komunale	Drejtori i Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë	Sektorin e pronës Kryetari i Komunës	Detyrë e përhershme	Shpallja e listës me uzurpime të pronës komunale.
OS3: Ngritja profesionale dhe kontrolli në zbatimin e ligjeve të pronës.				
Rishikimi dhe ngritja e kapaciteteve profesionale në sektorin e pronës	Drejtori i Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë	Sektorin e pronës	12/muaj	Trajnime profesionale sektoriale.
OS4: bashkëpunimi me organet: (Policinë, gjyqësorin etj).				
Vetëdijësimi i organeve tjera për ndihmë organeve komunale në mbrojtjen e pronës komunale.	Komuna e Drenasit	Drejtoritë tjera të komunës, Policia, Gjyqësia dhe Prokuroria	E përhershme	Raportet periodike lidhur me bashkëpunimin mes organeve.

OS5: Masat ndëshkuese për uzurpatorë të pronave komunale.

OS6: Masat ndëshkuese për zyrtarët komunalë që nuk veprojnë në harmoni me detyrat dhe përgjegjësitë në vendet e punës për ndalimin e uzurpimeve.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glogocit)

Kuvendi i Komunës

Nr. 360-904 dt 8 01 2016



Në bazë nenit 12 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në bazë të nenit 3 pika 1.1, neni 4 pika 1.1, neni 7 pika 1, neni 12 pika 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-164 Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimet Administrative, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit dhe Vendimit 06Nr.360-58659 të datës 20.10.2015 të Komisionit verifikues, raportit të këtij komisioni të datës 22.10.2015, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me dt.29.12.2015 miraton këtë:

VENDIM

I. LEJOHET vazhdimi i kontratave mbi dhënie në shfrytëzim të përkohëshem të banesave sociale në Bllokun e banimit I dhe II-të në Drenasin 3, të gjithë përfituesve të këtyre banesave sipas Ligjit Nr.03/L-164 Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimet Administrative edhe për 2(dy) vjet dhe atë prej skadimit të afatit të kontratave.

II. Kontrata për shfrytëzimin të përkohëshem të banesës sociale për banesën nr.13 në bllokun II do të lidhët me Pajtim Hadja, vëllau i përfituesës së kësaj banese Besa Hadja e cila është martuar dhe nuk jeton më në Drenasin III.

III. Gjendja ekonomike e familjeve dhe numri i banorve në Banimin Social, Bllokun I dhe II-të në Drenasin 3, sipas Aktvendimit të Përfituesve të përkohëshem të Banimit Social është përafërsisht në nivelin e kohës kur kanë përfituar të drejtën e Banimit Social.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Kryetari i Komunës duke nënshkruar kontratat për shfrytëzimin e përkohëshem të banesave sociale më përfituesit bazuar në raportin e komisionit verifikues-kontrollues dhe të miratuar nga Kuvendi Komunal-Drenas.

V. Me këtë Vendim do të njoftohen: Drejtoratët e Komunës së Drenasit,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor në Prishtinë dhe një mbetët për evidencë

VI. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe ligjshmerisë së dhënë nga MAPL-al



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)



Kuvendi i Komunës
12 Nr. 553-912 dt 08.01. 2016

Në bazë të nenit 11,12 dhe 40 të Ligjit nr. 03/L – 040 për vetëqeverisjen lokale, të nenit 34.pika 34.6, të Statutit të Komunës të Komunës së Drenasit, të datës 16.09.2008, Kuvendi i Komunës së Drenasit nw mbledhjen e rregullt te mbajtur me dt.29.12.2015 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR
NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË DRENASIT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret, kohëzgjatja e realizimit të bursës, dhe procedura për ndarjen e bursave për studentë/e të Komunës së Drenasit, të cilët studiojnë në universitete publike të Republikës së Kosovës.

Neni 2.

Komuna e Drenasit, do ti ndaj nga 50 (pesëdhjetë) euro për një muaj, dhe për dhjetë muaj do ti ndaj gjithësej: 500 euro, për student/e të rregullt të Komunës së Drenasit.

Neni 3.

1. Të gjithë studentët/et e rregullt, banorë të komunës së Drenasit, pa kurrfar dallimesh etnike, gjinore, racore, fetare dhe politike, që janë të regjistruar në fakultete të Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës, duke përjashtuar studentët/et në studime pasuniversitare – master dhe doktoratë, kanë të drejtë të konkurrojnë për ndarjen e bursave të studimeve.
2. Përparësi në fitimin e së drejtës në bursë do të kenë studentët/et që studiojnë në lëmenjtë deficitarë.

Neni 4.

Kryetari i Komunës merr vendim për numrin e bursave, që do të ndahen sipas fushave të studimeve, e që ndahet për një vit akademik - shkollor.

Neni 5.

1. Bursat për student/e do të ndahen nga Komisioni, i formuar me vendim të Drejtorit për Arsim në Komunën e Drenasit,
2. Komisioni do të jetë i përbërë nga 3 anëtarë, dy anëtar nga Drejtoria për Arsim dhe një antar i Kuvendit të Komunës.

Neni 6.

1. Drejtoria e Arsimit do të shpallë konkursin për ndarjen e bursave. Konkursi duhet të jetë i shpallur në mjetet e informimit, përkatësisht në dy gazeta ditore, në web-faqen e Komunës, në tabelën e shpalljeve, dhe do të qëndrojë i shpallur për 15 ditë.
2. Në konkurs do të përcaktohet dokumentacioni i kërkuar dhe informatat tjera të nevojshme.

Neni 7.

Drejtoria e Arsimit obligohet që t'i kryejë punët e domosdoshme tekniko-administrative që rrjedhin nga natyra e punës së Komisionit, si dhe punët rreth shpalljes së konkursit, pranimit të kërkesave, formulimit të kontratave e të ngjashme.

II. KUSHTET DHE KRITERET

Neni 8.

1. Për realizimin e së drejtës në bursë, kandidatët /et duhet t'i plotësojnë kushte si në vijim:
 - 1) Të kenë të regjistruar vitin akademik për të cilin jepet bursa;
 - 2) Të mos jenë shfrytëzues/e të ndonjë burse tjetër ose të punësuar;
 - 3) Bursa të jipet studenteve prej vitit të dytë deri tek apsulventet;
 - 4) të paraqesin dëshmi për gjendjen ekonomiko-sociale të familjes.
2. Gjendja ekonomiko-financiare e familjes së kandidatit/es vërtetohet në bazë të dëshmive të lëshuara nga Qendra për Punë Sociale në Drenas. Komisioni ruan të drejtën të hulumtojë dhe vërtetojë gjendjen reale ekonomiko-financiare të kandidatit/es.

III. KRITERET DHE PËRPARËSITË

Neni 9.

Për suksesin e arritur në mësim në vitin paraprak, kandidati/ja vlerësohet me pikë si në vijim:

- a) studenti/ja me notë mesatare nga nota 9 (nëntë) e më lartë, vlerësohet më 30 pikë;
- b) studenti/ja me notë mesatare nga nota 8 (tetë) e më lartë, vlerësohet më 20 pikë,
- c) studenti/ja me notë mesatare nga nota 7,5 (shtatë e gjysëm) e më lartë, vlerësohet më 15 pikë;
- d) studenti/ja në asistencë sociale, vlerësohen më 20 pikë;
- e) studenti/ja me studime në lëmenjtë deficitarë (1. Fakulteti i Edukimit – Programi Fillor, 2. a) Fakulteti i Arteve të Bukura – dega e artëve muzikore, b.) Programi pedagogji e përgjithshme muzikore, 3. Fakulteti Teknikë, 4. Fakulteti i Mjeksisë), vlerësohet më 5 pikë;

- f) studenti/ja që studiojnë së bashku më një anëtar/e nga e njëjta familje (vlla, motër), vlerësohet më 10 pikë;
- g) studenti/ja, i cili nuk i ka prindërit në jetë dhe është mbajtës i familjës, vlerësohen më 10 pikë;
- h) studenti/ja më aftësi të kufizuar vlerësohet më 10 pikë.
- l) student, fëmijë të dëshmoreve do të jenë përfitues të bursës komunale nëse i plotësojnë vetëm kriteret nga pika 1,2,3 e nenit 8 të kësaj rregullore.

Neni 10.

Në kushtet dhe kriteret e njëjta të cekura në nenin 9, do të kenë përparësi studentët e viktimave civile të luftës, të veteranëve, të invalidëve të luftës, të gjinisë femërore.

IV. VLERËSIMI I KUSHTEVE DHE KRITEREVE

Neni 11.

Pas skadimit të afatit të konkurrimit, komisioni do të bëjë vlerësimin e kërkesave. Gjatë procedurës së vlerësimit të kërkesave, komisioni do të përcaktojë metodën e punës dhe mënyrën e seleksionimit të kërkesave, gjithnjë duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 12.

1. Pas përfundimit të procedurës së seleksionimit, komisioni do të hartojë listën përgjithshme të kandidatëve/eve përfitues/e të bursës.
2. Lista e përfituesve do të shpallet publikisht dhe do të vendoset në tabelën e shpalljeve të Drejtorisë së Arsimit.

Neni 13.

1. Kundër vendimit për shpalljen e listës së përfituesve të bursave nga Komisioni për ndarjen e bursave, lejohet ankesa, e cila i drejtohet Komisionit të ankesave, i formuar "ad hoc" me vendim të Kryetarit të Komunës. Ankesa ushtrohet në afat prej 7 ditëve nga dita e shpalljes së listës së përfituesve të bursave nga ana e komisionit.
2. Komisioni për shqyrtimin e ankesave, në afat prej 15 ditësh duhet të vendosë lidhur me ankesën e ushtruar.

Neni 14.

1. Me përfituesit/et e bursave do të lidhet kontrata, e cila do të nënshkruhet nga Drejtori për Arsim dhe përfituesi/ja i bursës.
2. Nëse nuk nënshkruhet kontrata nga ana e studentit/es brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e njoftimit të kandidatit/es përfitues/e të bursës, do të konsiderohet se ka hequr dorë nga bursa dhe përfitues do të jetë kandidati që është në listë sipas radhës.
3. Kohëzgjatja për dhënien e bursës, obligimet e përfituesit/es të bursës dhe kushtet tjera, do të përcaktohen me kontratë.

V. PROCEDURA E PAGESËS

Neni 15.

1. Mjetet financiare do të alokohen me 1 (një) ose 2 (dy) periudha të caktuara gjatë vitit fiskal në xhirollogaritë bankare të përfituesve, në bankën të cilën studenti/ja e ka përzgjedhur.
2. Drejtoria kompetente për Financa dhe Drejtoria kompetente për Arsim, janë të obliguara të kujdesen për alokimin dhe zotimin e mjeteve të cekura më lart, në afatin kohor.

VI. DISPOZIATA SHFUQIZUESE DHE TË HYRJES NË FUQI

Neni 16.

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, pushon të vlejë akti i Komunës që ka rregulluar kushtet dhe kriteret për ndarjen e bursave.

Neni 17.

Kjo rregullore mund të ndryshohet më procedurë të njëjtë me atë të miratimit.

Neni 18.

Kjo rregullore hyn në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit të saj në tabelën e shpalljeve dhe në web-faqen e Komunës së Drenasit.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj